



Universiteti i Tiranës

FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE



BASHKIA
TIRANË

7032/

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Bashkisë së Tiranës

dhe

Fakulteti të Shkencave Sociale

Sot më datë 03/03 / 2016 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi midis palëve:

Bashkisë Tiranë me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” nr.1, 1001 Tiranë, përfaqësuar nga Kryetari I Bashkisë Tiranë, Z. Erion Veliaj, që këtej e tutje do të quhet “Bashkia” dhe

Universitetit të Tiranës, **Fakulteti i Shkencave Sociale** me adresë: Rruga “Milto Tutulani”, Tiranë, përfaqësuar nga Dekani I Fakultetit të Shkencave Sociale, Z. Theodori Karaj

Palët në këtë marrëveshje bashkëpunimi bien dakort për nënshkrimin e saj si më poshtë:

Neni 1

Objekti

Marrëveshja synon ngritjen e urave të bashkëpunimit midis dy institucioneve me qëllim mundësimin e angazhimeve të përbashkëta në studime, trajnime, seminare, konferanca, proçese të vlerësimit të shërbimeve, standardeve dhe kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve, praktikave mësimore, si dhe në hartimin e politikave të reja sociale, programeve dhe projekteve të shërbimeve për grupe dhe komunitete në nevojë.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin 7850 datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar).

Neni 3

Rolet dhe detyrimet e palëve

Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Punës dhe i Politikës Sociale merr përsipër:

- Të ofrojë kapacitetet e veta dhe ekspertizën për studime, programe dhe projekte që lidhen me fushën;
- Të kontribuojë me mendime, vlerësime dhe sugjerime për politika, programe dhe projekte;
- Të kontribuojë me trajnime dhe seminare për ngritjen e kapaciteteve të stafit në nivel lokal në fushën e shërbimeve sociale;
- Të organizojë studime për çështje sociale duke përfshirë në axhendë edhe prioritet, nevojat dhe interesat e Bashkisë;
- Të bashkëpunojë për nisma në fushën e komunikimit dhe promovimit te drejtësisë sociale për grupet vulnerable;
- Të marrë në konsideratë në studimet Master dhe Doktoraturë kandidaturat e sugjeruara nga Bashkia;

Bashkia Tiranë merr përsipër:


- Të përfshijë pedagogët e Departamenti të Punës Sociale dhe Politikës Sociale në studime shkencore mbi çështje/probleme/shërbime sociale; trajnime; konferanca; vizita studimore; debate për probleme që lidhen me fushën;
- Të krijojë grupe të përbashkëta pune për angazhime që lidhen me politikat, programet dhe projektet në fushën e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale;
- T’ju ofrojë studentëve një seancë orientimi ku të mund të nijhen me të, me stafin e tij si dhe politikat e institucionit dhe çështje të tjera administrative.
- Të caktojë anëtar/e të stafit që të ketë njohuritë edhe përvojën për të realizuar rolin e supervizorit/es për studentët praktikantë;
- Të mundësojë përfshirjen e studentëve të Punës Sociale dhe Administrimit të Politikës Sociale në praktikë mësimore brenda institucionit dhe në institucionet e varësisë, ku studentët që kryejnë praktikën sipas marrëveshjes.

- Të asistojë studentët që me mbikqyrjen e stafit profesionist të mund të punojnë drejtpërdrejt me përfituesit e shërbimeve shoqërore.
- Të pajisë studentët me vlerësimin për praktikën mësimore të kryer.
- Të ofrojë leksione për çështje të veçanta për studentët nga ekspertë të institucionit Bashkisë;
- Të sugjerojë kandidatura për studimet Master dhe Doktoraturë nga stafi i Bashkisë.

**Departamenti i Punës Sociale dhe
Politikës Sociale**

Përgjegjës

Prof. Dr. Edmond DRAGOTI



Bashkia Tiranë

Kryetar

Erion VELIAJ



Fakulteti i Shkencave Sociale

Dekan

Prof. Dr. Theodhori KARAJ

